



BASHKIA MIRDITË

BULETINI I MUAJIT SHTATOR 2025

Mirdita hap dyer të reja bashkëpunimi në Europë – Binjakëzohet me Bashkinë e Pezinokut në Sllovaki .

Më 19 shtator 2025, Bashkia Mirditë hodhi një hap të ri në forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit duke u binjakëzuar me Bashkinë e Pezinokut në Sllovaki.

Ceremonia solemne u zhvillua në qytetin e Pezinokut, ku kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, dhe homologu i tij sllovak, z. Roman Mács, nënshkruan Memorandumin e Binjakëzimit në prani të personaliteteve të larta diplomatike.

Në këtë event morën pjesë Ambasadori i Shqipërisë në Sllovaki, z. Arten Hanku, Ambasadori i Sllovakisë në Shqipëri, z. Albin Otruba, si dhe Presidenti i Rajonit të Bratislavës, z. Juraj Droba.

Ky binjakëzim, i cili u kurorëzua me mbështetjen e Ambasadës sonë në Sllovaki dhe asaj Sllovaqe në Tiranë, do të sjellë më afër komunitetet e bashkive respektive në promovimin e projekteve të përbashkëta në fusha të ndryshme, përfshirë zhvillimin ekonomik, arsimin, kulturën dhe ruajtjen e traditave folklorike.

Marrëveshja e bashkëpunimit është e dyta për Bashkinë Mirditë brenda këtij viti, duke dëshmuar përkushtimin ndaj zhvillimit dhe bashkëpunimit.

Së shpejti pritet finalizimi i një marrëveshjeje tjetër, ndërsa binjakëzimet e reja krijojnë mundësi për aplikime të përbashkëta në projektet e Bashkimit Evropian, duke fuqizuar zhvillimin lokal dhe rritjen e mundësive financiare për shërbime ndaj komunitetit.



TIP Mirdita - Program i mbështetjes financiare për start-up-et e të rinjve

TIP Mirdita është një program i Bashkisë Mirditë, në bashkëpunim me **GIZ Albania**, që mbështet të rinjtë në krijimin ose zgjerimin e sipërmarrjeve të tyre. Programi synon të fuqizojë zhvillimin ekonomik vendor, të krijojë vende të reja pune si dhe të ruajë e promovojë vlerat tradicionale, trashëgiminë kulturore dhe potencialin turistik e bujqësor të Mirditës.

Nëpërmjet një procesi konkurrues, **TIP Mirdita** do të identifikojë dhe mbështesë idetë më premtuese të të rinjve të zonës, që sjellin risi në fushën e turizmit, bujqësisë, blegtorisë, bletarisë dhe produkteve artizanale me identitet lokal.

Një juri profesionistësh do të vlerësojë aplikimet sipas kriterëve si: inovacioni, ndikimi lokal, fizibiliteti dhe kontributi në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Aplikantët e përzgjedhur do të përfitojnë:

Grante financiare nga 200,000 deri në 500,000 Lekë për të realizuar idenë e tyre brenda 6 muajve. Mentorim profesional gjatë gjithë procesit.

Pjesëmarrje në Demo Day (Dita e Demonstrimit), ku idetë do të prezantohen publikisht para një jurie profesionale me ekspertë të turizmit dhe bujqësisë, dhe idetë më premtuese do të kenë mundësi financimi.

Nëse je një i ri apo e re mirditore dhe ke një ide inovative që mund të ringjallë traditat dhe ekonominë e zonës, ky është momenti për ta shndërruar vizionin tënd në një realitet që kontribuon në të ardhmen e qëndrueshme të rajonit!



Mundësi të reja për fermerët dhe bizneset lokale në Mirditë.

Në datat 24 - 27 shtator 2025, Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, ishte në një vizitë zyrtare në Dhomën e Tregtisë, Industrisë dhe Agrikulturës së Kozenzës Itali, vizitë e organizuar me mbështetjen e Konsulles së Nderit të Shqipërisë në Kalabri, znj. Anna Madeo.

Në veprimtaritë e organizuara me këtë rast ishin të pranishëm gjithashtu përfaqësues të biznesit shqiptar, të shoqëruar nga Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, z. Nikolin Jaka.

Gjatë vizitës u zhvilluan takime B2B me rreth 70 sipërmarrës italianë, ku në qendër të diskutimeve ishin fushat e prodhimit vendas, bujqësia dhe agroturizmi.

Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, theksoi se këto bashkëpunime janë një hap i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe për promovimin e produkteve vendase.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, me datë 11 tetor 2025, do të kemi mundësinë të mirëpresim në Mirditë sipërmarrësit italianë, duke i afruar ata me fermerët lokalë dhe agroturizmat e zonës, për të krijuar mundësi konkrete për zhvillim dhe bashkëpunim.



Mbledhja e Këshillit Bashkiak Mirditë.

Me datë 30 shtator 2025 është zhvilluar mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Mirditë ku u miratuan projekt –vendimet e mëposhtme:

P/Vendim nr. 3629/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për bllok-ndihmën deri në **6%**, për periudhën **01 - 31 Gusht 2025**”, bashkia Mirditë

P/Vendim nr. 3731/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për bllok-ndihmën me fondine bashkisë, për periudhën **01 – 31 Gusht 2025**”, bashkia Mirditë

P/Vendim nr. 3138/2, prot. i Kryetarit të Bashkisë; “Për miratimin e hartës së linjave të transportit të mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit të tyre, për vitin arsimor 2025-2026 ”, bashkia Mirditë

P/Vendim nr. 3665/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të shqipërisë (TALGA)”

P/Vendim nr. 3018/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin, sistemimin e rrugës së automobilistike, që fillon nga “Përroi i Shangut dhe në vazhdim të lagjes Shtil deri në bashkim të rrugës ekzistuese”, fshati Klos, njësia administrative Fan, 4608”, bashkia Mirditë.

P/Vendim nr. 3744/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e hapjes së rrugës së re automobilistike që lidh lagjen Përgegaj (Shterë), fshati Shtuf, me rrugën ekzistuese të zonës, njësia administrative Kaçinar, 4607”, bashkia Mirditë

P/Vendim nr. 3742/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2025 - 2028, sipas kontratës së grantit IPA/2023/450-172 në kuadër të projektit; “Effort”, financuar nga Bashkimi Evropian

P/Vendim nr. 3783 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e anekseve të monitorimit të buxhetit, 8 - mujori (Janar - Gusht) viti 2025”, bashkia Mirditë

P/Vendim nr. 3784/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e Tabelave të situatës financiare deri me datë 31. 08. 2025”, bashkia Mirditë

P/Vendim nr. 3785/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2025”, bashkia Mirditë

P/Vendim nr. 3898/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e kalimit të pronësisë së truallit të dhënë për ndërtim, me objekt; banesë 9kt, Rrëshen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Rrëshen, me Vendim të KRRT-së nr. 4, datë 29.08.2006, në favor të Z. Bardhok Jushi, për efekt regjistrimi, në Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”

P/Vendim nr. 3899/1 prot i Kryetarit Bashkisë; “Për miratimin e kalimit të pronësisë së truallit të dhënë për ndërtim, me sipërfaqe 111 m², me numër pasurie 8/33 dhe 8/318, zona kadstrale 3224, nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Rrëshen, me Vendim të KRRT-së nr. 7, datë 04.07.2012, qyteti Rrëshen, në pronësi të bashkisë Mirditë”

P/Vendim nr. 3283/2 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.

P/Vendim nr. 3287/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.

P/Vendim nr. 3928/2 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.

P/Vendim nr. 3935/1 prot, i Kryetarit Bashkisë; “Për përdorim fond rezervë”, bashkia Mirditë.



Bashkia Mirditë fituese e projektit WiFi4WB.

Bashkia Mirditë është shpallur fituese e projektit WiFi4WB, një nismë e rëndësishme e bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Federale e Republikës së Gjermanisë, e zbatuar përmes projektit EU4Digital.

Ky projekt synon të ofrojë akses falas dhe të shpejtë në internet për qytetarët, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve digjitale dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik e social të komunitetit.

Përmes këtij projekti, do të mundësohet vendosja e pikave publike të WiFi-së falas në zona kyçe të qytetit, duke u ardhur në ndihmë të rinjve, bizneseve, institucioneve dhe vizitorëve.



#GrowthPlan

Implemented by



Mundësi të reja për fermerët dhe bizneset lokale në Mirditë.

Bashkia Mirditë në kuadër të bashkëpunimeve dhe iniciativave të vazhdueshme për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social, (Binjakëzimi me Komunën San Cosmo Albanese Itali, Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë me Dhomen e Tregtisë, Industrisë dhe Agrikulturës së Cosenzës Itali, si dhe Partneritetit me Madeo Group.)

Fton të gjithë fermerët, agroturizmat dhe bizneset lokale të marrin pjesë në një takim me përfaqësues të bizneseve italiane – një mundësi e vlefshme për bashkëpunime, investime dhe ide të reja.

Data: 11 Tetor 2025, Ora: 10:30 pranë QKF Mirditë

Aktiviteti synon të forcojë bashkëpunimin mes bizneseve shqiptare dhe italiane, të nxisë mundësi të reja investimi në Mirditë dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe sipërmarrës.

Ju mirëpresim!

FTESË

Mundësi të reja për fermerët
dhe bizneset lokale në Mirditë.

11 Tetor
Ora 10:00
QKF Rreshen